



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.85

Prishtinë, më 11.7.2024, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ardian Gola, Enis Kervan, Jahja Kokaj, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza dhe Adriana Matoshi.

**Munguan:** Albena Reshitaj, Eliza Hoxha, Ardian Kastrati dhe Vlora Dumoshi.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-277 për Sport;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-277 për Sport**

**Ardian Gola**, tha se me qëllim të qartësimit dhe evitimit të gabimeve teknike në mes të paragrafëve 1 dhe 2, si dhe në paragrafin 4 në amendamentin 31 në Raportin me rekomandime në Projektligjin nr. 08/L-277 për Sport, në pajtim me nenin 78 paragrafin 2 të Rregullores së Kuvendit kemi kërkuar ndërprerjen e shqyrtimit të amendamenteve dhe çështja të bartet në Komision, me qëllim të adresimit të çështjes së cekur më lartë dhe Kuvendit t'ia paraqesim për miratim raportin plotësues, si në vijim:

### **Raport plotësues për ndryshimin e Amendamentit 31 në Raportin me rekomandime në Projektligjin nr. 08/L-277 për Sport**

#### **Amendamenti 31**

Neni 47, ndryshohet si në vijim:

#### **Neni 47**

#### **Stimulimi financiar për arritjen e rezultateve sportive, shpërblimet financiare dhe kompensimi i përhershëm financiar**

1. Sportistët dhe trajnerët me potencial për arritjen e rezultateve kulmore sportive në Lojërat Olimpike, paraolimpike, garën e nivelit botëror ose evropian, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhë të caktuar kohore, në drejtim të arritjes së këtyre rezultateve.
2. Sportistët dhe trajnerët që arrijnë rezultate sportive kulmore në Lojërat Olimpike, Lojërat Paraolimpike, garat e nivelit botëror ose evropian, ju takon shpërblim i caktuar financiar.
3. Të drejtën për kompensim të përhershëm financiar e ka sportisti që duke përfaqësuar Republikën e Kosovës ka fituar medalje olimpike, paraolimpike, medalje në garën e nivelit botëror ose evropian.
4. E drejta për kompensim të përhershëm financiar fitohet vetëm për arritjen më të lartë të sportistit në sportin përkatës.
5. Vlera e kompensimit të përhershëm financiar nga ky nen ofrohet në baza mujore dhe caktohet nga ministri përgjegjës për sport. Vlera e kompensimit rishikohet në përputhje me faktorët ekonomikë.
6. Procesi i financimit nga ky nen udhëhiqet dhe zbatohet nga Agjencia e Sportit.

7.Procedura dhe kushtet për zbatimin e financimit nga ky nen përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga ministri përgjegjës për sport.

Komisioni pas diskutimeve, me shumicë votash, gjashtë (6) për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, vendosi që raportin plotësues me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-277 për Sport, ta procedojë për lexim të dytë.

### **3. Të ndryshme**

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:20.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Ardian Gola,**  

---

**Kryetar i Komisionit**